



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës
Kuvendi i Komunës

01 Klinë, 09.02.2026

Nr. 06 - 4191126

PROCESVERBAL

Nga mbledhja inauguruese e kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 11 Dhjetor 2025, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës

Në këtë mbledhje sipas Rendit të Ditës do të bëhet betimi i anëtarëve të Kuvendit, betimi i kryetarit të Komunës dhe zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit.

Pjesëmarrës janë: anëtarët e Kuvendit, kryetari i zgjedhur i komunës, z. Zenun Elezaj, ish kryesuesi i kuvendit, z. Fadil Gashi, përfaqësues të OVL të UÇK-së, Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të luftës, familjeve të personave të zhdukur gjatë luftës, komandanti i stacionit policor në Klinë, përfaqësues së Klerit katolik dhe përfaqësues të bashkësisë islame, z. Halil Krasniqi, përfaqësues të OSBE, KFOR, OJQ-ve, Mediat lokale dhe të tjera si dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi kryesues i kësaj mbledhjeje-anëtari më i vjetër i kuvendit të Komunës, z. Tunë Dedaj, i cili konstatoi kuorumin duke thënë se prezent janë 27 anëtarët e ri-në të zgjedhur nga zgjedhjet e fundit lokale. Z. Dedaj përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe vazhdoi më kryesimin e mbledhjes.

Për komisionin, prej tre anëtarëve, për verifikimin e mandateve propozohen:

1. Armend Beqiri
2. Leonard Veseli
3. Marigona Racaj

Me 27 vota të anëtarëve të Kuvendit MIRATOHET Komisioni.

Në emër të komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të kuvendit, z. Armend Beqiri, pas verifikimit të bërë, deklaroi se bazuar në listën e certifikuar nga KQZ, të gjithë anëtarët e kuvendit janë prezent dhe se mund të vazhdohet me punimet e seancës.

Kryesuesi z. Tunë Dedaj duke cituar nenin 35/4 të ligjit për vetëqeverisje lokale, fton të gjithë anëtarët e Kuvendit të ngritën në këmbë dhe lexojnë deklaratën e betimit.

dallim, më jep përgjegjësi më të madhe që të punoj me nder dhe përgjegjësi, përkushtim dhe profesionalizëm, që çdo ditë e më shumë të realizojmë projekte që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët tanë.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, dua t'ju përgëzoj të gjithëve për marrjen e detyrës së re, njëkohësisht ju ofroj bashkëpunimin tim të plotë për realizimin e kërkesave të qytetarëve tanë të cilët na dhanë besimin që t'ju shërbejmë me përgjegjësi, llogaridhënie dhe transparencë.

Qytetarë të dashur, edhe më tutje, edhe në katër vjetët e ardhshëm, synojmë të bëhemi shembulli më i mirë i qeverisjes në gjithë Kosovën dhe ju ftoj të gjithëve për bashkëpunim. Na priftë e mbara! Ju faleminderit!

Në radhë është zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit dhe z. Tunë Dedaj sqaron procedure bazuar në rregulloren dhe ligjet në fuqi. Ai kërkon që të formohet komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit. Kërkon që të propozohen tre anëtarë.

Propozohen:

- 1. Enver Kadri Berisha**
- 2. Jehona Gashi**
- 3. Asdren Ramadani**

Komisioni aprovohet një zëri nga 26 anëtarë të Kuvendit. Një anëtar(LVV) e braktisë sallën.

Nga AAK propozohet për kryesues z. Enver Berisha. Propozime të tjera nuk ka.

z. Esat Raci: Kushdo që të zgjidhet ne i urojmë suksese. Ne si grup kuvendar I PDK nuk kemi ndonjë qëndrim sa i përket kryesuesit. Kemi vërejtjet tona sa i përket këtij pushteti. Jemi në seancë inauguruese dhe të gjithë anëtarëve ju urojmë suksese. Apeli im për gjeneratat e reja në këtë kuvend është që të punojnë për të mirën e qytetarëve. Ne nuk kemi qëndrim, të gjithë janë të lirë të vendosin vet. Unë do të qëndroj në seancë por nuk do të marrë pjesë në votim.

Komisioni sistemohet në vendin përkatës dhe fillon me punë përgatitore për votim të fshehtë.

Në emër të komisionit, znj. Jehona Gashi fton një nga një anëtarët e Kuvendit që të marrin fletëvotimin dhe të votojnë. Kësaj ftese i përgjigjen gjithsejtë 22 anëtarë të kuvendit. Katër anëtarë nuk votojnë fare(4 nga 9 anëtarët e PDK) dhe një anëtar braktisë sallën(LVV).

Në përfundim të votimit komisioni jep rezultatet ku nga 27 anëtarët e kuvendit kanë marrë pjesë vetëm 22 anëtarë dhe nga këta , 16 janë PËR, 2 janë kundër dhe 4 janë abstenim.

Komisioni deklaron se kryesuesi I ri I kuvendit të Komunës është zgjedhur z. Enver Berisha të cilin e fton për një fjalë rasti.

z. Enver Berisha, kryesues i Kuvendit: Përsëritet të gjithëve. Të nderuar të pranishëm(përsëritet të gjithë veç e veç). Është nder dhe privilegj që për këto katër vitet e ardhshme të jem pjesë e këtij kuvendi dhe është zotim imi para juve se do të vazhdoj në mënyrë transparente , të ndershme dhe në interes të qytetarëve. Ju siguroj që me këtë përbërje të re të dalur nga vota e

lirë e qytetarëve do të jem bashkëpunues. Ju falënderoj për besimin e dhënë. Ju ftoj që ta argumentojmë votën e qytetarëve dhe të jemi bashkëpunues. Na shkoftë puna mbarë.

z. Tunë Dedaj falënderon të gjithë dhe fton kryesuesin e sapo zgjedhur, z. Enver Berisha që të ulet në vendin e vet duke i uruar për detyrën e re.

z. Enver Berisha duke falënderuar të gjithë dhe duke ju uruar të gjithëve anëtarëve të kuvendit për mandatin e ri, e shpallë të mbyllur këtë seancë solemne inauguruese

Procesmbajtës:
Skënder Behramaj



Kryesuesi i Seancës:

Tunë Dedaj

